



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nr. 17356  
prot.

Tiranë, më 21.5.2022

URDHËR

Nr. 218, datë 21.5.2022

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR VERIFIKIMIN E INSTRUMENTEVE  
MATËSE LIGJËRISHT TË KONTROLLUARA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 22, pika 6, i Ligjit Nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për metrologjinë”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Rregullores “Për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhëri.
2. Të gjithë instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike në përputhje me Rregullin Teknik, miratuar me VKM Nr.770, datë 2.11.2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet matëse”, për disa ndryshime në Vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërish të kontrolluara”, dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, i nënshtrohen verifikimit i cili mund të jetë fillestar, pasardhës, periodik, i rregullt, i kryer në intervale kohore specifike dhe jashtë rradhe.


Në varësi të analizës së riskut dhe problematikave të tregut të evidentuara dhe të raportuara nga Personi Juridik privat, Koncesionari, i autorizuar me një nga format e parashikuara në ligj, por në çdo rast jo më pak se 5%, periodiciteti i verifikimeve është objekt dyfishimi, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 22 të Ligjit 126/2020 “Për metrologjinë”.

3. Kjo rregullore zbatohet për verifikimin e instrumenteve matës ligjërish të kontrolluara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe personave privatë të

autorizuar prej saj, si edhe nga personi juridik privat, Koncesionari, ekskluzivisht i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm.

4. Urdhëri nr. 195, datë 9.03.2009 “Për verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara” i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.
5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, personat e autorizuar prej saj, si dhe personi juridik privat, Koncesionari, ekskluzivisht i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar në fushën hidrokarbure dhe gazit të lëngshëm për zbatimin e këtij urdhri.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**  
**Delina IBRAHIMAJ**



# **RREGULLORE “PËR VERIFIKIMIN E INSTRUMENTEVE MATËSE LIGJËRISHT TË KONTROLLUARA”**

## **PJESA 1**

### **PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT FILLESTAR TË INSTRUMENTEVE MATËSE LIGJËRISHT TË KONTROLLUARA**

#### **Përkufizime**

##### **Neni 1**

Përkufizimet apo termat e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me ato të dhëna në dispozitat e Ligjit Nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për metrologjinë”, kontrata koncesionare apo akte rregullatorë të tjera që kanë forcën zbatuese të ligjit.

#### **Dispozita të Përgjithshme**

##### **Neni 2**

Verifikimi fillestar është ekzaminimi i një instrumenti matës të ri ose të riparuar përpara se të përdoret, dhe vërtetimin e përputhshmërisë së tij me tipin e miratuar sipas Rregullit Teknik miratuar me VKM Nr.770 dt. 2.11.2016 “Për miratimin e rregullit teknik për instrumentet matëse, për disa ndryshime në vendimin nr. 1351 dt. 3.10.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluar” dhe përcaktimin e listës së standarteve të harmonizuara (këtu e në vijim quajtur Rregulli Teknik) lidhur me instrumentin matës në fjalë.

##### **Neni 3**

Verifikimi fillestar i instrumenteve matës, që nuk janë objekt i markimit CE, kryhet sipas procedurave, të parashikuara në Rregullin Teknik, përfshirë por pa u kufizuar këtu edhe ato të përcaktuara në kontratën koncesionare, dhe në përputhje me dispozitat dhe procedurat e parashikuara në këtë Rregullore.

##### **Neni 4**

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, apo personat juridikë privatë të autorizuar për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, kryejnë verifikimin fillestar të instrumenteve matës që kanë karakteristikat e matjes sipas Rregullores së Këshillit të Ministrave dhe që përmbushin kërkesat funksionale dhe teknike të ndërtimit, të dhëna në Rregulloren e Këshillit të Ministrave për këtë kategori të instrumenteve.

## **E drejta e Aplikimit për verifikim**

### **Neni 5**

Të drejtën e aplikimit për kryerjen e verifikimit fillestar e kanë prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi, ose përdoruesi i instrumentit matës (këtu e në vijim quajtur “Aplikanti”).

Prodhuesit ose importuesit e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara në fushën e hidrokarbureve dhe gazit të lengshëm duhet të kryejnë kundrejt pagesës regjistrimin e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar bazuar në dokumentacionin shoqërues, përpara hedhjes së tyre në treg ose vendosjes për përdorim. Në çdo rast dhe në çdo fazë të vendosjes në përdorim, instrumenti që hidhet në treg, duhet të përmbajë të gjitha pjesët origjinale në përputhje me projektin konstruktiv të instrumentit matës.

### **Neni 6**

Aplikimi për verifikim fillestar paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë sipas formatit të përcaktuar në Aneksin 1.1 bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.

Në rastet e verifikimeve të instrumenteve matëse nga persona juridikë privatë, Koncesionari, ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, aplikimi bëhet sipas formatit të miratuar nga Koncesionari, format i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje si Aneksi nr.1.2.

## **Ekzaminimi për verifikim fillestar të instrumenteve matëse**

### **Neni 7**

Kur një instrument matës nënshtrohet procesit të verifikimit fillestar, ekzaminimi do të përcaktojë:

- (a) Nëse instrumenti i takon asaj kategorie të përjashtuar nga miratimi i tipit nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si dhe nëse janë plotësuar kërkesat dhe karakteristikat teknike e metrologjike dhe të konstruksionit teknik që përcaktohen në Rregullin Teknik lidhur me këtë instrument matës.
- (b) Nëse instrumenti matës ka marrë miratimin e tipit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, si dhe nëse është në përputhje me tipin e miratuar dhe Rregullin Teknik për këtë kategori instrumentesh matëse, që është në fuqi ditën e miratimit të tipit nga DPM-ja.
- (c) Nëse është në përputhje me Rregullin Teknik përkatësisht me:
  - i. karakteristikat teknike e metrologjike;
  - ii. gabimet maksimale të lejueshme;
  - iii. ndërtimin, për sa ai garanton që karakteristikat e matjeve nuk përkeqësohen deri në një farë shtrirje nën kushtet normale të përdorimit;
  - iv. prezencën e mbishkrimeve të përshkruara dhe pllakave apo masave për shenjat e verifikimit.

v. elementë të tjerë teknike të parashikuar në kontratën koncesionare.

### **Fiksimi i shenjave të verifikimit fillestar në instrumentet matëse**

#### **Neni 8**

Kur një instrument matës kalon me sukses procesin e verifikimit fillestar sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose personi juridik i autorizuar prej saj autorizon vendosjen e shenjës së verifikimit fillestar pjesor dhe të plotë të përshkruar/përmbajtur në një Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Metrologjisë.

### **Kryerja e verifikimit fillestar**

#### **Neni 9**

Verifikimi fillestar kryhet në një apo më shumë faza.

### **Kryerja e verifikimit fillestar me një fazë**

#### **Neni 10**

Verifikimi fillestar do të kryhet në një fazë mbi ato instrumente që përbëjnë një të tërë kur dalin të tilla nga fabrika dhe që transferohen në vendin e instalimit pa patur nevojë që më parë të çmontohen.

#### **Neni 11**

Procedura e verifikimit fillestar me një fazë duhet të sigurojë në veçanti që instrumenti është në përputhje me miratimin e tipit dhe nërastet kur është i përjashtuar nga miratimi i tipit, nëse është në përputhje me masat e parashikuara në Rregullin Teknik.

#### **Neni 12**

Verifikimi fillestar i instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, të karburanteve dhe gazit të lëngshëm kryhet në çdo rast dhe pa kufizime, në vendin ku janë të instaluar, para se ato të vendosen në përdorim.

Verifikimi fillestar i instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, të karburanteve dhe gazit të lëngshëm përfshin:

- a) ekzaminimin e instrumentit matës dhe vërtetimin e përputhshmërisë së tij me tipin e miratuar, sipas certifikatës së miratimit të tipit që vihet në dispozicion si detyrim i përdoruesit ose poseduesit të instrumentit matës për verifikim fillestar sipas përcaktimeve të Rregullit Teknik.
- b) Vlerësimin e dokumentacionit teknik që shoqëron certifikatën e miratimit të tipit dhe

deklaratën e konformitetit të lëshuar nga prodhuesi, nëse janë në përputhje me dispozitat e Rregullit Teknik.

Në të gjitha rastet kur verifikimi fillestar kryhet nga personi juridik privat, Koncesionari, ekskluzivisht i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar në fushën hidrokarbure dhe gazit të lëngshëm, është detyrim i përdoruesit/poseduesit të instrumentit matës për vendosjen në dispozicion për ekzaminim të instrumentit, si edhe dokumentacionin e kërkuar sipas përcaktimeve të Rregullit Teknik.

Në rastet kur personit juridik privat, Koncesionarit, ekskluzivisht i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e verifikimit fillestar të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, nuk i vihet në dispozicion dokumentacioni i kërkuar dhe certifikata e miratimit të tipit të instrumentit matës ose ajo nuk përputhet pas ekzaminimit të kryer me dispozitat e parashikuara në Rregullin Teknik, njoftohet struktura përgjegjëse e inspektimit për mbikëqyrjen e tregut për marrjen e masave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

### **Kryerja e verifikimit fillestar në dy faza**

#### **Neni 13**

Verifikimi fillestar do të bëhet me dy faza për ato instrumente funksionimi korrekt i të cilëve varet nga kushtet që ato instalohen ose përdoren.

### **Vendi i verifikimit fillestar**

#### **Neni 14**

Nëse sipas parashikimeve të Rregullit Teknik nuk specifikohet vendi i kryerjes së verifikimit fillestar, ky verifikim do të kryhet me një fazë në vendin që zgjidhet nga shërbimi metrologjik përkatës.

#### **Neni 15**

Verifikimi me dy faza i instrumenteve kryhet në vendin e instalimit nga shërbimi metrologjik kompetent apo personi juridik privat, Koncesionari, ekskluzivisht i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar në fushën hidrokarbure dhe gazit të lëngshëm. Fazat e tjera të verifikimit kryhen në përputhje me parashikimet e nenit 111 të kësaj Rregulloreje.

## **Neni 16**

Në veçanti kur verifikimi kryhet në vende jashtë ambienteve të shërbimit metrologjik, shërbimi metrologjik mund të kërkojë nga subjekti:

- Të vendosë në dispozicion etalonë dhe mjete të tjera materiale dhe personel ndihmës për kryerjen e verifikimit fillestar;
- Të japë një kopje të certifikatës së miratimit të tipit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

## **Tipi dhe vlefshmëria e shenjave të verifikimit fillestar**

### **Neni 17**

Tipi i shenjës së verifikimit fillestar do të përshkruhet me Urdhër të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ndërsa në rastet e kryerjes së verifikimit fillestar të instrumenteve matëse, nga një person juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, tipi i shenjës së verifikimit fillestar përshkruhet nga ky person juridik privat/koncesionari në përputhje me kontratën koncesionare. Integriteti i shenjës së verifikimit fillestar është i pacënueshëm dhe rreptësisht i ndaluar për tu prekur apo dëmtuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë nga asnjë subjekt tjetër, përveç koncesionarit.

Çdo ndërhyrje apo prekje e drejtëpërdrejtë apo e tërthortë në shenjën e verifikimit përbën kundravajtje administrative sipas ligjit 126/2020 “Për Metrologjinë”, përveçse kur përbën vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 18**

Vlefshmëria e shenjës së verifikimit fillestar të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, personit juridik të autorizuar prej saj apo personit juridik privat Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, zgjat nga momenti i vendosjes deri në fillim të verifikimit pasardhës.

**Formati i kërkesës për verifikim fillestar**  
**APLIKIM PËR VERIFIKIM**  
**FILLESTAR**  
**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË OSE PERSONI**  
**JURIDIK I AUTORIZUAR**

**1. Të dhënat e përgjithshme të aplikantit**

**Emri i Subjektit prodhues apo përfaqësuesit të tij në**  
**Shqipëri.....**

.....  
.....

**Adresa e subjektit aplikues**

.....  
.....  
.....

**Nr. regjistrimit të subjektit**

.....  
.....

**Personi i kontaktit**

.....

**Nr.Tel.....**

**Nr.Fax.....**

**E-mail.....**

**2. Tipi i instrumentit matës për vlerësim/verifikim<sup>(\*)</sup>**

<sup>(\*)</sup> Shënim: Pjesa nr. 2 e kërkesës varion nga tipi dhe fusha e matjeve që i përket tipi i instrumentit matës i cili do të vlerësohet.

**Formati i kërkesës për verifikim fillestar**

**APLIKIM PËR VERIFIKIM  
FILLESTAR**

**SHOQËRISË KONCESIONARE “NOA INSPECT” SH.P.K**

(elementët do të plotësohen nga Shoqëria Koncesionare)

## **PJESA 2**

# **PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT PASARDHËS TË INSTRUMENTEVE MATËSE LIGJËRISHT TË KONTROLLUARA**

### **Përkufizime**

#### **Neni 1**

Përkufizimet apo termat e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me ato të dhëna në dispozitat e Ligjit Nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për metrologjinë”, kontrata koncesionare apo akte rregullatore të tjera që kanë forcën zbatuese të ligjit.

### **Dispozita të Përgjithshme**

#### **Neni 2**

Verifikimi pasardhës i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara që kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, personi juridik i autorizuar prej saj apo nga personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, përfshin:

a. verifikimin periodik të rregullt

b. verifikim jashtë rradhe i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara i cili bëhet në rastet kur:

i. instrumenti nuk ka qenë në përdorim për shkak të defektit apo mangësive teknike;

ii. është kryer riparimi;

iii. në rastin kur instrumenti matës nuk i është nënshtruar verifikimit periodik të rregullt në afatin kohor të parashikuar;

iv. ka një kërkesë nga subjektet për certifikimin e tërësisë së kerkesave teknike e metrologjike për të siguruar transmetim automatik të të dhënave (regjim automatik);

v. ka një kërkesë për kryerjen e tij nga:

-institucionet shtetërore përkatëse ose institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut dhe instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara që gjenden në treg;

-subjekti juridik/pronari i instrumenteve matëse;

-përdoruesi i instrumenteve matëse;

-konsumatorët, të cilët pretendojnë se janë dëmtuar nga funksionimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluar;

-personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e verifikimeve, sipas Ligjit Nr. 126/2020,

datë 15.10.2020 “Për metrologjinë”, kur vlerësohet e nevojshme prej tyre.

### Neni 3

Verifikimi pasardhës i një instrumenti matës kryhet para se të mbarojë periudha e vlefshmërisë të verifikimit dhe certifikimit të mëparshëm, me kërkesë të përdoruesit ose kur verifikimi i tij nuk është më i vlefshëm.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, personi juridik i autorizuar prej saj, personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, përcaktojnë grafikun e kryerjes së verifikimeve pasardhëse.

Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike, bëhet jo më pak se dy herë në vit dhe përfshin kontrollin dhe sigurimin e regjimit automatik.

### Neni 4

Verifikimi i një instrumenti matës ligjërisht të kontrolluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, personat juridike të autorizuar prej saj apo nga personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm nuk është i vlefshëm nëse:

- a) Kërkohet gjatë kohëzgjatjes aktive të periudhes së verifikimit të mëparshëm;
- b) Ka mbaruar kohëzgjatja e periudhes së verifikimit të mëparshëm;
- c) Instrumenti matës i nënshtrohet një modifikimi/riparimi nga pale te treta, që ndikon në karakteristikat e tij teknike e metrologjike. Në cdo rast instrumentit matës nuk do t'i vendosen pjesë këmbimi që nuk janë pjesë dhe konform e projektit konstruktiv të tij por i vendosen pjesë këmbimi të prodhuesit/importuesit;
- d) Instrumenti matës është prekur ose dëmtuar në një menyrë të tillë, që i është cenuar integriteti ose që ai humbet disa karakteristika të tij thelbësore të verifikimit të mundshëm ose qëllimin e tij të përdorimit dhe kur kjo vlerësohet me argumentim teknik të dokumentuar nga ana e personit juridik që kryen shërbimin;
- ç) Shenja e verifikimit është hequr, dëmtuar dhe/ose shkatërruar;
- e) Instrumenti matës ka humbur karakteristikat teknike e metrologjike të kërkuara, megjithëse shenja e verifikimit nuk është dëmtuar dhe/ose shkatërruar;
- f) Vendi i instalimit të instrumentit matës është ndryshuar ose zhvendosur;
- g) Për çdo rast tjetër të parashikuar nga ligji 126/2020 “Për metrologjinë” dhe kontrata e koncesionit.

## **Neni 5**

Verifikim periodik i rregullt i instrumenteve matës është verifikimi që kryhet periodikisht në intervale të specifikuara, në përputhje me këtë Rregullore dhe me procedurën e përcaktuar në dokumentacionin integral të kontratave koncesionare.

## **Intervalet e riverifikimit**

### **Neni 6**

Verifikimi periodik i rregullt i detyrueshëm kryhet sipas intervaleve kohore të parashikuara në Aneksin 2.1 të kësaj rregulloreje.

Intervalet e verifikimit periodik të rregullt të të gjitha instrumenteve matëse të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, kryerja e të cilit bëhet ekskluzivisht nga një person juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, parashikohen në kontratën koncesionare përkatëse, këtë rregullore dhe kuadrin ligjor rregullator në fuqi.

### **Neni 7**

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si dhe personi juridik i autorizuar prej saj, janë të detyruar të përdorin të njëjtët intervale verifikimi për të njëjtin instrument.

Person juridik privat, i autorizuar prej saj apo nga personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, zbaton intervalet e verifikimit të përcaktuara në këtë Rregullore, kontratën koncesionare, dhe kuadrin ligjor përkatës lidhur me të gjitha instrumentet matëse.

### **Neni 8**

Në rastet kur instrumentet matëse në përdorim i nënshtrohen verifikimit periodik të rregullt dhe kryhen vetëm nga person juridik i autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, është detyrim që këto intervale të përshkruhen në Aneksin 2.1 të kësaj Rregullore.

## **Komponentët e verifikimit pasardhës**

### **Neni 9**

Ekzaminimi i verifikimit pasardhës ndahet në tre komponentë të dallueshëm, metrologjik, teknik dhe administrativ.

## **Neni 10**

Elementet me kryesore të ekzaminimit gjatë verifikimit pasardhës janë:

- i. karakteristikat metrologjike;
- ii. kontrolli dhe certifikimi i tërësisë së kushteve metrologjike për transmetimin automatik të të dhënave
- iii. gabimet maksimale të lejueshme;
- iv. konstruksioni, në ato përmasa që të garantojë që karakteristikat e matjes nuk priren të keqësohen në kushte normale të përdorimit;
- v. prezenca e mbishkrimeve të përshkruara dhe pllakat apo masat e marra për fiksimin e shenjës së verifikimit pasardhës etj.

## **Regjistri i instrumenteve matëse në përdorim subjekt i kontrollit metrologjik ligjor**

### **Neni 11**

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë të nxjerrë një urdhër për krijimin e regjistrit të evidentimit të kontrolleve të instrumenteve matëse. Në këtë urdhër përshkruhen rregullat e përdorimit, formati, instruksionet për plotësimin dhe ruajtjen e regjistrit të instrumenteve matëse në përdorim subjekt i kontrollit metrologjik ligjor.

Në rastet e verifikimeve të instrumenteve matëse, të kryera nga personi juridik privat Koncesionari i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, regjistri i evidentimit të këtyre verifikimeve bëhet nga ky person juridik privat/Koncesionari sipas dispozitave të kontratës koncesionare përkatëse dhe dokumentacionit integral të saj.

### **Neni 12**

Me përjashtim të rasteve të mbajtjes së regjistrit të evidentimit të verifikimeve të instrumenteve matëse, të kryera nga personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, regjistri i instrumenteve matëse në përdorim, subjekt i kontrollit metrologjik ligjor, do të mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë pavarësisht nga fakti që është Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë apo personi juridik i autorizuar prej saj që kryen verifikimin pasardhës.

### **Neni 13**

Është detyrim i personit juridik të autorizuar prej Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për kryerjen e verifikimit të instrumenteve matëse, t'i japë Drejtorisë së Përgjithshme të

Metrologjisë të gjithë informacionin e duhur për të bërë të mundur plotësimin e regjistrit të instrumenteve matëse në përdorim subjekt i kontrollit metrologjik ligjor.

Sa herë lind nevoja, personat juridikë të autorizuar prej Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, detyrohen t'i japin të gjithë informacionin e duhur për të bërë të mundur plotësimin e regjistrit të instrumenteve matëse në përdorim, subjekt i kontrollit metrologjik ligjor, personave juridikë privatë të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e instrumenteve matës, sipas dispozitave të kontratës koncesionare përkatëse dhe dokumentacionit integral të saj.

### **Planifikimi vjetor i verifikimit pasardhës**

#### **Neni 14**

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, personi juridik i autorizuar prej saj, si dhe personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm hartojnë planin vjetor për verifikimin pasardhës për vitin e ardhshëm, bazuar në situatën aktuale të regjistrit të instrumenteve matës në përdorim, subjekt i kontrollit metrologjik, duke përdorur evidencat e dhëna nga metrologët e autorizuar apo inspektorët metrologë, për përdoruesit e rinj të instrumenteve matëse dhe bazuar dhe në kërkesat e reja të subjekteve përdorues të instrumenteve matëse, subjekt i kontrollit metrologjik.

#### **Neni 15**

Personat juridikë të autorizuar prej Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për kryerjen e verifikimit, do të hartojnë planin e tyre vjetor të verifikimit dhe duhet t'i japin Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë informacion të detajuar rreth këtij plani.

### **Planifikimi vjetor i verifikimit pasardhës për instrumentet matës të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm**

#### **Neni 16**

Personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, harton planin e tij vjetor të verifikimit në të gjitha pikat e tregimit me pakicë dhe shumicë dhe informon mbi planin sipas dispozitave përkatëse të Kontratës së Koncesionit.

## **Kryerja e verifikimit pasardhës të instrumenteve matëse në kushtet e veta**

### **Neni 17**

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, personi juridik i autorizuar prej saj apo personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, respektivisht, kryejnë verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, në kushtet e veta dhe në vendet e verifikimit të tregtimit me pakicë dhe shumicë.

### **Neni 18**

Transportueshmëria e instrumenteve matëse që i nënshtrohen verifikimit dhe instrumenteve të verifikimit mund të diktojë zgjedhjen e vendit të verifikimit pasardhës.

## **Kryerja e verifikimit pasardhës në vendin e përdorimit të instrumenteve matëse**

### **Neni 19**

Verifikimi i instrumenteve matës të një tipi të veçantë ligjërisht të kontrolluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, personi juridik i autorizuar prej saj apo personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm kryhet në vendin e tregtimit me pakicë ose shumicë ku janë të instaluar këto instrumente.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, personi juridik i autorizuar prej saj apo personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, kryen verifikimin e instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në vendet e tregtimit me pakice ose shumice ku janë vendosur, ndërfutur apo instaluar instrumentet matëse, në rastet kur një instrument matës ligjërisht i kontrolluar, për shkak të konstruksionit, është i lidhur me vendin e instalimit, ose në raste të instrumenteve matëse që, për shkak të konstruksionit të tyre, mund të dëmtohen apo thyhen gjatë levizjes ose transportit.

### **Neni 20**

Subjekti përdorues i instrumenteve matëse në përdorim, subjekt të kontrollit metrologjik ligjor duhet të sigurojë akses në vendin e instalimit dhe tek vetë instrumenti matës, si dhe të vendos në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, personit juridik të autorizuar të autorizuar prej saj apo personi juridik privat, Koncesionarit, ekskluzivisht të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e të

gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, mjete dhe personel te nevojshëm si dhe të kryejë pagesën që lidhet me verifikimin pasardhës.

### **Përdorimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të riparuar**

#### **Neni 21**

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, personi juridik i autorizuar prej saj apo personi juridik privat, Koncesionari, ekskluzivisht i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, përcaktojnë periudhën kohore të përdorimit të instrumentit pas riparimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, e cila në çdo rast nuk duhet të kalojë 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i kryerjes së riparimit.

Në çdo rast që konstatohet nevoja për riparim, subjektet që përdorin instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara në çdo pikët të tregtimit me pakicë dhe shumicë duhet të njoftojnë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë/subjekte të autorizuar prej saj për të kryer riparimin, si edhe personi juridik i autorizuar prej saj personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të kryer verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, për të kryer verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, për nevojën e kryerjes së riparimit, duke e nxjerrë menjëherë jashtë funksionimit instrumentin matës ligjërisht të kontrolluar, nga momenti i njoftimit derisa të përfundojë procesi i riparimit.

### **Verifikimi pasardhës i sistemeve matëse**

#### **Neni 22**

Verifikimi pasardhës i sistemeve matëse në pikat e tregtimit me pakicë dhe shumicë do të kryhet duke përdorur një nga opsionet:

- a) verifikimi veç e veç i instrumenteve matëse që përfshihen në sistemin matës;
- b) verifikimi i sistemit matës si një i tërë.

### **Verifikimi i instrumenteve matëse, vlerësimi i konformitetit të të cilëve bëhet sipas ligjit të vlerësimit të konformitetit**

#### **Neni 23**

Të gjithë instrumentet matëse konformiteti i të cilëve vlerësohet sipas ligjit “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore”, do t’i nënshtrohen të gjitha procedurave të

verifikimit pasardhës në çdo pikë të tregtimit me pakicë dhe shumicë si të gjithë instrumentet e tjera matëse në përdorim, objekt i kontrollit metrologjik ligjor.

### **Tipi dhe vlefshmëria e shenjave të verifikimit pasardhës**

#### **Neni 24**

Tipet e shenjave të verifikimit pasardhës do të përshkruhen me Urdhër të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Tipet e shenjave të verifikimit pasardhës të të gjithë instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm do të përshkruhen nga personi juridik privat, Koncesionari, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm.

#### **Neni 25**

Personat juridike të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë janë të detyruar të përdorin shenjat e verifikimit pasardhës të përshkruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

#### **Neni 26**

Vlefshmëria e shenjave të verifikimit mbaron kur përfundon intervali i verifikimit pasardhës të përshkruar në nenin 6, Pjesa 2 e kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 27**

### **Rastet e ndërhyrjeve të paautorizuara objekt verifikimi**

Çdo ndërhyrje apo prekje e drejtpërdrejtë apo e tërthortë në shenjë të verifikimit apo në kontrollin dhe sigurimin e regjimit automatik nga institucione shtetërore apo subjekte të tjera të autorizuar për mbikëqyrjen dhe kontrollin e çdo tatimpaguesi në fushën e tregtimit të hidrokarbureve, pa miratim paraprak të DPM ose personit të autorizuar prej saj ose personit juridik privat, Koncesionarit, i autorizuar ekskluzivisht me një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për verifikimin e të gjitha instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, përbën kundërvajtje administrative sipas ligjit 126/2020 për metrologjinë, përveçse kur përbën veprë penale sipas Kodit Penal të RSH-së.

#### **Neni 28**

### **Sanksione dhe penalitetet**

Rastet kur verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara pengohet me çfarëdo lloj forme nga subjekti përdorues/pronar, do të konsiderohen shkelje të rënda të këtij ligji.

**Tabela e intervaleve të verifikimit periodik të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar**

TABELA 1

| Nr.                                                                                       | EMERTIMI I INSTRUMENTIT MATËS                                                                                                                                                                                       | Afati i detyrueshëm për verifikimin periodik në muaj |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|
| <b>MATËSIT MATERIALE TË GJATËSISË</b>                                                     |                                                                                                                                                                                                                     |                                                      |
| 1                                                                                         | Matësit e gjatësisë (druri,metalike, shirit etj) që përdoren në tregëti e shërbime                                                                                                                                  | 12                                                   |
| <b>TAKSIMETRAT/TAHOGRAPHET</b>                                                            |                                                                                                                                                                                                                     |                                                      |
| 2                                                                                         | Taksimetra<br>Tahografe                                                                                                                                                                                             | 12<br>24                                             |
| <b>MASAT E KAPACITETIT TË SHËRBIMIT, MASAT VOLUMORE DHE CISTERNAT RRUGORE (AUTOBOTET)</b> |                                                                                                                                                                                                                     |                                                      |
| 3                                                                                         | Rezervuarë matës për transport të lëngjeve të prodhimeve ushqimore (qumësht, pije alkolike, uthull etj)<br><br>- Autobote , vagonçisterna,çisterna<br>- Bucela dhe fuçia prejdruri<br>- Bucela dhe fuçia prejmetali | 24<br>12<br>36                                       |
| 4                                                                                         | Autobote, cisterna për transport të produkteve të naftës.                                                                                                                                                           | 24                                                   |
| 5                                                                                         | Përcaktimi i vëllimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të fuçive, kadeve dhe çisternave prej druri për mbajtjen e pijeve alkolike dhe                                                                                |                                                      |

|                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                      |
|-------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
|                                           | uthullës<br>- Pas verifikimit të parë<br>- Pas çdo verifikimi periodik                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 12<br>36             |
| 6                                         | Përcaktimi i vëllimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të fuçive,<br>kadeve dhe cisternave prej materiali jo druri për mbajtjen e naftës<br>dhe produkteve të saj, e lëngjeve të prodhimeve ushqimore (pije alkoolike, uthull, qumësht etj.)<br>- Pas verifikimit të parë<br>- Pas çdo verifikimi periodik<br>- Shkallëzimi i nivelit të tankerit dhe transmetuesit të nivelit | 24<br>60<br>24       |
| 7                                         | Masa vëllimore prej qelqi (gota , ballon , etj.) me një shenjë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 1 herë pas prodhimit |
| 8                                         | Masa vëllimore jo prej qelqi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 12                   |
| 9                                         | Masa vëllimore për lëndë të thata<br>• Për vëllime të vogla<br>• Për vëllime të mëdha                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 12<br>12             |
| <b>GRAMARËT ( e klasës M1.M2.dhe M3 )</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                      |
| 10                                        | Gramarë të klasës M1 që përdoren për matjen e mallrave të çmuara, në laboratorë, në farmaci etj.                                                                                                                                                                                                                                                                              | 12                   |
| 11                                        | Gramarë të klasës M2 dhe M3 që përdoren për matje kryesisht në sektorët e shërbimeve të tregtisë etj.                                                                                                                                                                                                                                                                         | 12                   |

## INSTRUMENTAT JOAUTOMATIK TË PESHIMIT

|    |                                                       |    |
|----|-------------------------------------------------------|----|
| 12 | Peshore elektronike                                   | 12 |
| 13 | Peshore që përdorin gramarë të klasës M1              | 12 |
| 14 | Peshore që përdorin gramarë të klasës M2 dhe M3       | 12 |
| 15 | Peshore me platformë, automobilistike dhe hekurudhore | 12 |

## SISTEME TË MATJES SË SASIVE TË LËNGJEVE PËRVEC UJIT

|    |                                                        |   |
|----|--------------------------------------------------------|---|
| 16 | Aparate të shpërndarjes të karburanteve për automjete  | 6 |
| 17 | Aparate të shpërndarjes së LPG për automjete           | 6 |
| 18 | Dozatorë të mbushjes me lëng                           | 6 |
| 19 | Kontalitra për shpërndarësit e mëdhenj të karburanteve | 6 |
| 20 | Kontalitra të autoboteve të karburanteve               | 6 |
| x  | Instrumente matës të vëllimit dhe temperaturës         |   |

## PËR MATJEN E SASISË TË KALIMIT

|    |                                                                                                            |     |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 21 | Njehsorë të matjes së ujit të ftohtë                                                                       | 60  |
| 22 | Njehsorë njëfazorë të matjes së energjisë elektrike                                                        | 96  |
|    | dhe nëse partia e të njëjtit prodhim del e rregullt shtyhen edhe 60 muaj të tjera verifikimet pasardhëse   | 156 |
| 23 | Njehsorë tre fazorë të matjes së energjisë elektrike                                                       | 96  |
|    | dhe nëse partia e të njëjtit prodhimin del i rregullt shtyhen edhe 60 muaj të tjera verifikimet pasardhëse | 156 |

## ALKOLMETRAT, ALKOLHIDROMETRAT DHE TERMOMETRAT PËR PËRCAKTIMIN E FORTËSISË SË ALKOOLIT

|    |                  |                        |
|----|------------------|------------------------|
| 24 | Alkoolmetra      | 6                      |
| 25 | Alkoolhidrometra | Një herë pas prodhimit |

|                                                     |                                                                                                                                                    |                        |
|-----------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|
| 26                                                  | Termometra për përcaktimin e fortësisë së alkoolit                                                                                                 | Një herë pas prodhimit |
| <b>MAKINAVE TESTUESE NJË AKSIALE TË MATERJALEVE</b> |                                                                                                                                                    |                        |
| 27                                                  | Makina të provave të materialeve :<br><br>- Me ngarkesë statike një aksiale në shtypje dhe tërheqje.<br><br>- Makina testuese në shtypje për beton | 12<br><br><br><br>12   |
| <b>PËR INSTRUMENTAT MATESE TË FUSHAVE TË TJERA</b>  |                                                                                                                                                    |                        |
| 28                                                  | Aparatet për kontrollin e presionit të fryrjes së gomave të automjeteve                                                                            | 12                     |
| 29                                                  | Dozatorë të mbushjes me trupa të ngurtë (sheqer, oriz etj.)                                                                                        | 6                      |
| 30                                                  | Instrumente të matjes së masës hektoliter (masës standarte të grurit)                                                                              | 24                     |
| <b>PËR RADARËT E MATJES SË SHPEJTËSISË</b>          |                                                                                                                                                    |                        |
| 31                                                  | Radarë të matjes së shpejtësisë                                                                                                                    | 6                      |